



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Shtojca 10

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

[Datë 11.07.2024]

Drejtuar: SINANI TRADING shpk me NIPT J64103483H, adresa: Fier Lushnje Lushnje, Lagja “Karbunarë e Poshtme”, Rruga e Beratit, Km 1, Magazinë 2 katëshe, Numri i Pasurisë 652/132, Zona Kadastrale 2087.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur e thjeshtuar, Mall.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-06603-05-27-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje artikuj ushqimor kolonial (ambalazhuar/paketuar)”, sasia: sipas shtojcës 6, afati: 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 29 datë 3 Qershor 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. 3 - SH shpk

NIPT K62721401R

Vlera: 4’453’245 (katër milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e pesë) lek

2. SINANI TRADING shpk

NIPT J64103483H

Vlera: 4'581'104.25 (katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e katër presje njëzet e pesë) lek

3. NELSA shpk

NIPT J71601012S

Vlera: 5'202'765 (pesë milion e dyqind e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lek

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **3 - SH shpk**

NIPT K62721401R

për arsyet e mëposhtme:

- Për ofertuesin **3 - SH me NIPT K62721401R**, me vlerë të ofertës **4'453'245 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **3 - SH:**

1. Nuk përmbush piken 2.1.1 të Kapacitetit Profesional ku citohet se "*Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit: Për OE/BOE: Licensa të jetë e lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme: Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve; Nënkatëgoria: II.1.A.1 Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Licensa duhet të jetë në emër të OE të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga AK", pasi në përmbushje të këtij kriteri ofertuesi ka paraqitur licencën e kategorisë II.1.A.1, me nr LN-9859-07-2015, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë "*Përpunim, paketim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Fruta të thata, niseshte, fasule, oriz, miell, vaj, makarona)*", veprimtari e cila nuk përfshin të gjithë artikujt e objektit të prokurimit për të cilin ka ofertuar, duke u kufizuar vetëm në artikujt fruta të thata, niseshte, fasule, oriz, miell, vaj, makarona. Ky konstatim bazohet edhe në arsyetimin e KPP në vendimin nr. 411/2022, me nr. 553/9 prot., datë 29.04.2022.*

2. Nuk përmbush piken 2.3.3 të Kapacitetit Teknik ku citohet se "*Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira ambient të përshatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave që janë objekt i këtij prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratën e marrjes me qira të objektit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambienti duhet të plotësojë kushtet higjieno sanitare dhe teniko teknologjike, vërtetuar kjo nga organet kompetente në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*" si dhe ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "*Për ushqimin*", i ndryshuar.*

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë për disponimin dhe adresën e saktë të ambientit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të ambientit".

Referuar dokumentacionit të paraqitur, ofertuesi ka paraqitur kontratën e qirase për një magazinë me sipërfaqe 250 m², pa përcaktuar numrin e pasurisë, dhe pa e shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë së objektit në emër të qiradhenesit.

Ne te njejten kohe, ofertuesi nuk ka paraqitur deklaratë per disponimin dhe adresen e saktë te ambientit.

4. 2. NELSA shpk

NIPT J71601012S për arsyet e mëposhtme

- Për ofertuesin **NELSA me NIPT J71601012S**, me vlerë të ofertës **5'202'765 lekë**, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **NELSA**:

1. Nuk permbush piken 2.1.1 te Kapacitetit Profesional ku citohet se *“Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit: Për OE/BOE: Licensa të jetë e lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme: Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve; Nënkategoria: II.1.A.1 Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Liçensa duhet të jetë në emër të OE të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga AK”,* pasi ne permbushje te ketij kriteri ofertuesi ka paraqitur licencen e kategorise II.1.A, me nr LN-0366-03-2020, me emertimin pershkrues te veprimtarise *“Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumice e ushqimeve për njerëz (Ambalazhim i frutave dhe perimeve)”*, veprimtari e cila nuk eshte ne perputhje me objektin e prokurimit per te cilin ka ofertuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: SINANI TRADING shpk me NIPT J64103483H, adresa: Fier Lushnje Lushnje, Lagja “Karbunarë e Poshtme”, Rruga e Beratit, Km 1, Magazinë 2 katëshe, Numri i Pasurisë 652/132, Zona Kadastrale 2087., se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: 4'581'104.25 (katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e katër presje njëzet e pesë) Lek/totali i pikëve të marra [_____], është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.